




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/ Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1, 2 shkronja d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe neni 11 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 (MAPL) për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe neni 14 paragrafi 1, 2 shkronja d) i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullte të mbajtur me datë 30.01.2026 mori këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), Komuna Skenderaj)

Neni 1

Miratohet propozimi me Nr.02-020/01-0003479/26, i datës 22.01.2026 Për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), në Komunën e Skenderajt, me këtë përbërje:

1. **Sami Lushtaku**-Kryetar i Komunës-njëherit Kryesues i KKS-së,
2. **Agim Idrizi**-Komandant i Stacionit të Policisë në Skenderaj, anëtar,
3. **Ibrahim Hoti**-(Përfaqësues i BIK), përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të Komunës, anëtar;
 - 3.1. **Milutin Kovaqeviq**-(Përfaqësues i krishterë-prift i kishës në Bajë), përfaqësues Legjitim i secilës bashkësi fetare të Komunës, anëtar;
4. **Dejan Shapiq**-(Përfaqësues i komunitetit serbë), përfaqësues i secilit komunitet etnik të komunës, anëtar,
 - 4.1. **Milaim Dani**-Përfaqësues i komunitetit ashkali, përfaqësues i secilit komunitet etnik të komunës, anëtar,
 - 4.2. **Sefadin Radonqiq**-Përfaqësues i komunitetit boshnjak, përfaqësues i secilit komunitet etnik të komunës, anëtar,
5. **Gordana Tomiq**-Kryesuesja e komitetit për komunitete i Kuvendit të Komunës, anëtare,
6. **Qefsere Dauti**-Zyrtar për Barazi Gjinore, anëtar,
7. **Kastriot Duraku**-Drejtör i DKA-së, anëtar
8. **Avdi Jakupi**-Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës,
9. **Edolind Vishaj**-Përfaqësues i FSK-së, anëtar,
10. _____-Përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike, anëtar
11. _____-Kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
12. **Sokol Hoxha** -Përfaqësues i Sektorit të Emergjencave Civile Komunale, anëtar
13. **Nedelko Kovaqoviq** - Përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar
14. **Milazim Mustafa** - Përfaqësues i OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, anëtar,
 - 14.1. **Avdi Tahiraj**– Përfaqësues e Komunitetit të biznesit.
 - 14.2. **Arsim Haziraj**– Përfaqësues i Handikos Skenderaj.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi janë të përcaktuar me Udhëzimi administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 (MAPL) për këshillat komunal për siguri në bashkësi.

Neni 3

Mandati i anëtarëve në këtë komitete është (4) katër vjeçare, i njëjtë me anëtarët të Kuvendit.

Neni 4

Kompensimi për mbledhje që i mbajnë është i përcaktuar në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimit do të kujdeset; Kryetari i Komunës së Skenderajt.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen të Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

1x1 Anëtarëve të Komisionit,
1x1 MAPL-së,
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 Arkivit,
1x1 Dosjes.





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu-Alija, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL
Zyrtaret përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Skenderajt

I nderuar Kryetar,

E nderuar Kryesuese,

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.01-020/01-0004913/26 për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) Komuna Skenderajt
I miratuar më datë: 30.01.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.02.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislationit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2026, ka miratuar vendimi Nr.01-020/01-0004913/26 për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) Komuna Skenderaj.

MAPL konstaton se akti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt, është bazuar në nenin 12, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, vendimi Nr.01-020/01-0004913/26 për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) Komuna Skenderaj është miratuar në mbledhjen e të rregullt të Kuvendit të Komunës së Skenderajt e mbajtur me dt.30.01.2026, është miratuar me 21 vota për, 0 votë kundër, 4 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.